



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 05.05.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e ndryshimit nr. 4 të marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme”.
2. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, A. Prenga.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Blendi Klosi, Tom Doshi, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduart Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Mimoza Loli - përgjegjëse e Sektorit të Huamarrjes, Drejtoria e Drejtimit të
Borxhit Publik

Elona Mistrovica – Ministria e Financave

Sonila Qato - Drejtore e Përgjithshme

Olsi Raklli - zëvendës drejtor i Përgjithshëm dhe drejtor i Kompensimit të
Pronave

Ketrin Treska - drejtore në Drejtorinë e Oponencës Ligjore

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit meqenëse kuorumi i nevojshëm për të çelur mbledhjen është realizuar. Kemi filluar me vonesë për shkak të disa angazhimeve politike të kolegëve deputetë. Ndër të tjerave dhe faktit që sot është 5 maji dhe janë edhe homazhet në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit këtu në Tiranë dhe në varrezat e dëshmorëve nëpër rrethe. Kjo e vështirësoi këtë mbledhje për të filluar në orar.

U kërkoj të ftuarve ndjesë për këtë fakt që u detyruan të presin, por ishte për një arsye objektive!

Vazhdojmë me rendin e ditës.

Projektligji i parë është “Për ratifikimin e ndryshimit nr. 4 të marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme”.

Nga Ministria e Financave nëse ka diçka të veçantë jashtë kësaj që është në tekstin e marrëveshjes mund ta parashtroni.

Po, zonjë. Prezantohuni!

Mimoza Loli – Përshëndetje! Unë jam Mimoza Loli, shefe e borxhit të jashtëm në Ministrinë e Financave.

Qëllimi i këtij amendim-marrëveshjeje është që në kuadër të marrëveshjes bazë që është lidhur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas të cilës ata kanë rënë dakord të japin një grant prej 28 milionë e 544 mijë dollarë, por sipas procedurave që ata zbatojnë shuma nuk jepet menjëherë, por shuma aktive bëhet në zbatim të viteve të tyre fiskalë. Kështu që deri tani kanë dhënë 19 milionë e 397 mijë e 953 dollarë dhe për vitin 2014, bëhet fjalë gjithmonë për vitin fiskal të tyre, japin një shtesë prej 2 milionë e 560 mijë dollarë.

Pra, qëllimi i këtij amendimi është që këto para të futen në përdorim. Fushat ngelen po të njëjtat që janë të përcaktuara në marrëveshjen bazë.

Fatmir Xhafaj – Nuk ndryshon nga marrëveshja bazë.

Faleminderit!

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Besoj se kolegët relativimin tim e kanë përpara. Është një marrëveshje kuadër dhe i ftoj ta votojnë të gjithë pro.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje? Ka diskutime? Nuk besoj.

Dakord në parim.

Kalojmë tani në diskutimin nen për nen. Këshilltari, zoti Bledi, ka bërë një sugjerim me të drejtë në aspektin e teknikës legjislative. Pas fjalës “të qëndrueshme” të vendoset dhe fjala “dhe gjithëpërfshirëse”, sepse marrëveshja bazë është e tillë që në titull. Jeni dakord?

Mimoza Loli – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Ky është ndryshim titulli.

Neni 1. Jeni dakord? Dakord.

Neni 2. Jeni dakord? Dakord.

Mimoza Loli – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Kalojmë te votimi në tërësi.

Jeni dakord? Faleminderit!

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 05.05.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.07.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, A. Prenga.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Blendi Klosi, Tom Doshi, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduart Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Sonila Qato - drejtore e Përgjithshme e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

Olsi Raklli - zëvendës drejtor i Përgjithshëm dhe drejtor i Kompensimit të Pronave

Ketrin Treska - drejtore në Drejtorinë e Oponencës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë.

Fatmir Xhafaj - Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.07.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar”.

Janë të pranishëm për të paraqitur projektin, zonja Sonila Qato, drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, zoti Raklli në cilësinë e zëvendës drejtorit dhe zonja Ketrin Treska, drejtore në Drejtorinë e Oponencës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë.

Zonja Qato, mund të bësh një përmbledhje të shkurtër të projektit, meqenëse deputetët e kanë njohur projektin.

Po, zonja Qato.

Sonila Qato - Faleminderit!

Të nderuar zotërinj anëtarë të komisionit,

Ministria e Drejtësisë, me propozim të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, paraqitet këtu me një propozim, në kuptimin e një projektligji për ndryshimin e ligjit aktual në fuqi “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”. Ndryshimet të cilat ne propozojmë konsistojnë në dy nene të ligjit në fuqi, të cilat kanë të bëjnë me afatin e funksionimit të fushës që vepron ligji “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, sikurse edhe të mandatit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Afati i shtyrjes të cilët ne propozojmë, Ministria e Drejtësisë dhe me vendim të qeverisë është 6 muaj dhe qëllimi për të cilën kemi kërkuar shtyrjen e këtij afati me 6 muaj ka të bëjë me faktin sepse aktualisht me propozim të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Ministria e Drejtësisë është duke punuar mbi një draft, projektligj të ri, për të ndryshuar një herë ligjin “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”. Përderisa jemi ende në momente reflektimi konsultimi me ekspertët e Këshillit të Europës dhe të Zyrës së Regjistratit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, kërkojmë pak kohë dhe afat për të finalizuar këtë proces, procesin e konsultimeve me ta dhe procesin e konsultimeve publike për të cilat kërkohet një transparencë akoma më e madhe dhe kohën e nevojshme për reflektimin e grupeve të interesit.

Ndaj ne mendojmë që një afat 6-mujor i shtyrjes së ligjit në fuqi është shumë i nevojshëm për finalizimin e këtij procesi, në kuadrin e një reforme të nisur nga ana jonë, nga njëra ana dhe nga ana tjetër nuk mund të pezullohet procesi i funksionimit normal të

agjencisë për shkak sepse kërkesat e qytetarëve të cilët kanë lidhje me këtë proces janë të vijueshme, ashtu sikurse janë të vijueshme dhe disa procedura të tjera të përfshira në këtë ligj.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Fjalën e ka relatori, zoti Fino.

Bashkim Fino - Do të thosha që ju fatkeqësisht më keni vënë mua relator, sepse ose më keni vënë kastile, **që t'i bie** më fort ose më ke vënë relator që të mos flas fare.

Fatmir Xhafaj – Kjo tregon që ne nuk shikojmë konfliktet e interesit këtu.

Bashkim Fino – Herën e fundit, para 6 muajsh, kur ne kemi diskutuar në këtë tavolinë, kemi thënë dakord, po e shtyjmë 6 muaj ligjin e kthimit dhe kompensimit të pronave. Është i pranueshëm dhe mjaftueshëm, thamë. Mos do të vini prapë të kërkon shtyrjen e tij? Po të hapësh procesverbalet, dhe janë atje në sekretari, të shohësh janë pyetje që unë i kam bërë për këtë gjë dhe na është thënë që 6 muaj janë më se të mjaftueshëm.

Tani kam dhe një problem të dytë në këtë që tha Kryetarja e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për të cilën kam respekt. Në fakt në relacion nuk është ky thelbi përse këta kërkojnë shtyrjen e projektligjit. Në relacion këta thonë që për shkak se ka një fluks të madh të dosjeve të kthimit të pronave, si zakonisht, ne kërkojmë shtyrjen për 6 muaj të kthimit dhe kompensimit të pronave. Ndërkohë që kryetarja këtu na tha një gjë më objektive, më të drejtë, diçka që duhet marrë në konsideratë, që ne jemi duke bërë një ligj të ri “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” që do të thotë, zoti kryetar, se relacioni i paraqitur nga qeveria nuk përputhet me atë çka kërkon kryetarja e kthimit dhe kompensimit të pronave në këtë komision që mua më duket shumë objektiv, që vërtet mbase ka ardhur koha të bëhet një ligj tjetër që t'i jepet fund.

Por unë dhe një herë tjetër kam thënë që të mos e marr fjalën përsëri, ky është një projektligj shumë i thjeshtë, sepse thjesht kërkohet një ndryshim kohor, 6 muaj, dhe nuk ka ndonjë gjë të madhe. Por thelbi për të cilën ne diskutojmë ka shumë gjëra për të diskutuar, sepse ne kemi thënë dhe themi si procesi i legalizimit, ashtu dhe procesi i kthimit të pronave nuk janë procese në pafundësi. Janë procese të cilat kërkojnë një afat maksimal se kur do të përfundojnë. Mua më vjen keq ta them këtë gjë, dhe kritikoj

qeverinë time për këto 18 muaj. Imagjino qeverinë e Fatmir Mediut për 8 vjetët që ishin në pushtet, që është dhe kryetari i Partisë Republikane që mbron pronarët, nuk bëri asgjë.

Nga 2004 që është bërë ligji dhe deri në 2015-n, e dua për procesverbal, që në nëntor kur të vijë prapë projektligji të mos na kërkohet shtyrje dhe të them se çfarë kam thënë për Fatmirin, jo për Fatmirin si kryetar, por për Fatmirin republikan; pra, nga viti 2004 e deri tani në 2015-n, më vjen keq të të them, është bërë shumë pak nga të gjitha llojet e qeverive, por natyrisht më shumë nga e djathta, se ata kanë qenë 8 vjet në pushtet, ne 1 vit e gjysmë kemi. Ky proces nuk mund të zvarritet më. Ne mund ta japim opinionin dhe verdiktin tonë për ta shtyrë 6 muaj, por nuk është kjo çështja, se këtë e bëjmë dhe nuk ka asnjë lloj problemi. Problemi është përfaqësuesit e qeverisë këtu dhe kryetarja e kthimit të pronave duhet të na thonë se mbas bërjes së këtij ligji që mendojnë se duan 6 muaj për ta bërë ligjin, kur mbaron ky proces? Ka ndonjë afat? Ka ndonjë gjë që i duhet thënë Kuvendit se kur mbaron ky proces? Se problemi i këtij projektligji është shumë i thjeshtë, shtyhet 6 muaj, por unë jam prapë po jo realist, jam skeptik, sepse nuk e di se çfarë do të ndodhë pas 6 muajve. Domethënë mbas 6 muajve, të paktën kështu e kuptova kryetare, do të vijë ligji i ri i kthimit të pronave dhe te ky ligj i ri që bie ky ligj automatikisht pastaj.

Pra, në njëfarë mënyre shumë interesante, brilante na tregojnë mjaft bukur si në futboll nuk na bien më zoti kryetar shtyrje afati, por do të na sjellin një ligj, të ri i cili do të kërkojë ca afate të reja, që nuk ka nevojë të shtyhen afatet, mbasi i kemi shtyrë nja 2-3 herë. Ky është thelbi i gjithë diskutimit që unë bëj për këtë çështje. Dhe unë pavarësisht se jam i një partie të majtë, e ngre zërin sikur të jem Fatmir Mediu. Kërkoj të di se kur mbaron ky proces? Kur del ligji dhe kur mbaron procesi i kthimit dhe i kompensimit të pronave, sepse nuk mund të vazhdojë ky proces i stërzgatur. Nuk e kam personale me ju, sepse ju thashë një vit keni në atë vend pune. E kam më shumë me Fatmirin, për hir të së vërtetës, që është përfaqësues i së djathtës dhe nuk bëri asgjë. Dhe me sa duket do të bëjmë ndonjë ligj të ri për t'i dhënë zgjidhje Fatmirit dhe të gjithë fatmirëve të tjerë për kthimin dhe kompensimin e pronave.

Prandaj unë them kryetar që ta mbyllim tamam këtë punë, t'ia japim dhe një herë dorën, por jo për 6 muaj, pak më shpejt. Ta sjellin sa më shpejt, për 3 muaj. Këtë

gjë e kam serioze. Të na e sjellin ligjin sa më shpejt këtu në parlament, sepse ligji i ri pastaj vë konture, afate të tjera të cilat ne nuk kemi nevojë t'i diskutojmë më.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Unë e vlerësoj koherencën tuaj dhe jo rastësisht ju jeni relator, sepse e keni ndjekur këtë çështje me një përkushtim të veçantë si ligjvënës. Keni qenë shumë aktiv, kontribues në këtë çështje dhe për këtë arsye prandaj keni qenë në vazhdimësi dhe jeni ende me këtë projekt relatori i çështjes.

Zoti Mediu, ju lutem!

(Diskutim pa mikrofon)

Fatmir Mediu – ...që tha zoti Fino.

Fatmir Xhafaj – Unë besoj se zoti Mediu do ta përmbledhë.

Fatmir Mediu – Dakord! Kam edhe ca pyetje, prandaj. Por një koment po e bëj, që tha zoti Fino. Qëllonte që sa herë dilja nga kjo derë e Kuvendit, për nja pesë vjet, ishte një burrë i gjatë. Kishte qenë aviator, ndjesë pastë tani! Sa herë dilja, më thoshte: Çfarë po bën me pronat? Unë i thosha: po bëjmë këtë, po bëjmë atë. Një ditë e pyes: “Po për cilën parti voton ti?”. “Për PS-në”, më thotë mua. “Po çfarë kërkon nga unë, ti?” “Po pronat i ke ti, - tha, -me PS-në jam unë”.

Kështu që, ky muhabet është një çikë...

(Diskutim pa mikrofon)

Tashti, se çfarë ka bërë qeveria, për ato vite që ka bërë, unë mendoj se ka shqyrtuar dosje, ka kthyer, ka kompensuar, por jo atë që duhej të bënte; në mënyrë të padiskutueshme ka një përgjegjësi shumë të madhe.

(Diskutim pa mikrofon)

Ta mbaroj pra. Do t'i jap edhe me shifra, por jo këtu. Unë kam shumë respekt për kryetarin dhe për gjithë punën që bëj. Ajo që mua më shqetëson është fakti që ju thoni se ne do të pezullojmë procesin. Pra, kërkon një shtyrje prej gjashtë muajsh, ose nuk e keni shqyrtuar, nuk i jeni përmbajtur afatit, sepse ka një ligj në shqyrtim.

Ju jeni strukturë ekzekutive, për të implementuar ligjin aktual. Ju nuk jeni një strukturë që supozoni se ç'do të vijë nga ligji tjetër, që të pezulloni funksionin tuaj edhe

për gjashtë muaj të tjera që kërkoni për shqyrtim. Pra, në këto gjashtë muaj që ju kërkoni shqyrtim, nuk do të ketë ndonjë veprim ekzekutiv nga ana juaj. E para kjo.

E dyta, ju jeni Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Do të desha një përgjigje nga ana juaj, se sa dosje keni shqyrtuar ju nga viti 2013, kur keni filluar punën, deri në vitin 2015? Pyetja e dytë: sa vendime keni për kthimin dhe kompensimin? I bëj gjithë këto pyetje për një arsye. Domethënë, duke besuar te relacioni, ku ju thoni se ne e kërkojmë për shkak të efektit të punës së komisionit, gjë që nuk është kështu.

Ky gjashtëmujor që po ju japim, a ju krijon mundësinë për të marrë ndonjë vendim të caktuar për kthim dhe kompensim të pronave? Domethënë, flas nga pikëpamja fizike, sepse ajo financiare është një proces tjetër, që ju e keni nisur tashmë.

Ajo që do të bëja si pyetje shtesë të kësaj është: sa është sot fondi i kompensimit apo i kthimit fizik, që ju keni në dispozicion? Ju keni rreth tetë mijë dosje, nëse s'jam gabim, tetëmijë e treqind dosje. Tetëmijë e treqind dosje nuk u shqyrtuan dot nga 2013 deri në 2015-ën. Gjashtë muaj, a janë të mjaftueshme për t'i shkuar edhe asaj çka ngre si shqetësim kolegu im Fino?

(Diskutim pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Mediu!

Zonja Qato, ju lutem!

Sonila Qato – faleminderit!

Si fillim, do të doja të sqaroja relatorin

(Diskutim pa mikrofon)

Jo, vetëm për faktin që në

(Diskutim pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Jo, jo.

Sonila Qato – Jo, jo, zoti Fino, jo në kuptimin e sqarimit individual.

(Diskutim pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Jo, jo, ajo do të sqarojë problemin.

(Diskutim pa mikrofon)

Sonila Qato – Ndjesë. Në rregull.

Do të doja të sqaroja se pjesë e relacionit të projektligjit është edhe fakti – që është përmendur në relacion – se sot në Ministrinë e Drejtësisë është depozituar draft –

projektligji i ri për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave. Pra, ne nuk jemi në një proces, le të themi, draftimi apo shkrimi të këtij drafti. Tashmë drafti është përfunduar. Propozimi ynë është dorëzuar në Ministrinë e Drejtësisë dhe ne jemi në një fazë konsultimi me ekspertët e Këshillit të Europës dhe të Zyrës së Regjistrimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, pasi ata janë duke e parë në aspektin e mbrojtjes së të drejtave, nga Konventa Europiane e të drejtave të Njeriut, për shkak edhe të problematikës së madhe që ka shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Strasburgut dhe masa e lartë e dëmshpërblimeve të caktuara në këto vendime për shtetin shqiptar dhe për qeverinë shqiptare.

(Diskutim pa mikrofon)

Drafti është përgatitur nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nën mbikëqyrjen e një grupi pune, i cili përbëhet nga Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit, Ministria e Ekonomisë, si dhe nga Ministria e Financave. Kjo, sepse këta janë konsideruar si faktorët kryesorë, të cilët do të japin inputet e tyre për hartimin e këtij draftligji. Prandaj për të arritur tek shkruarja e këtij draftligji, agjencia në një vit e gjysmë ka punuar shumë fort, për të krijuar për herë të parë disa statistika e të dhëna konkrete, në lidhje me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave në njëzet e tre vjet proces, nga viti 1993 deri më sot. Kjo është bërë nëpërmjet një pune fizike të të gjithë stafit të agjencisë, nëpërmjet konfirmimit të gjithë arkivit, të cilën ne e kemi të trashëguar, që për hir të së vërtetës ka qenë një arkiv shumë problematike, ku vetë pronarët janë ballafaquar me problemet e këtij arkivi, për shkak të moskonfirmimit të dosjeve të tyre, humbjes mosinventarizimit, jopasqyrimin digjital të tyre nga njëra anë. Nga ana tjetër, ne për herë të parë kemi punuar për të nxjerrë një faturë kompensimi. Pra, sa do t'i kushtojë shtetit shqiptar kompensimi i pronarëve, mbi bazën e ligjit aktual në fuqi, në mënyrë që, duke parë se sa i kushton sot, të krijojmë një ligj të ri, me një mekanizëm dhe me një formulë të re, për ta përballuar këtë proces me realizëm?

Pra, ideja e projektligjit të ri, të cilin duam të propozojmë pas gjashtë muajsh në parlament, do të jetë një projektligj me të cilin kemi ambicien t'i japim një drejtim dhe një përfundim procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Faleminderit! besoj se situata është e qartë.

Pyetjet u konsumuan, besoj.

(Diskutim pa mikrofon)

Po e bërë një koment.

Fatmir Mediu – Atëherë, duke vlerësuar përgjigjen e kryetares së Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, dua të insistoј përsëri në një fakt. Ju jeni strukturë ekzekutive implementuese. Pavarësisht nga ngarkesat, detyra juaj nuk është përgatitja e projektligjit, sa ç'është implementimi për kthimin dhe kompensimin e pronave. Besoj se kjo është edhe përgjegjësia që keni marrë përsipër. Fakti që nga 2013 deri në 2015 nuk ka vendimmarrje për kthimin dhe kompensimin e pronave, nuk mund të justifikohet me atë ngarkesë që keni pasur, në gjykimin tim. Nga ana tjetër, ju po përgatisni një draftligj, ose keni përgatitur një draftligj, por duhet t'i ktheheni një çikë historisë së kësaj çështjeje, pavarësisht se unë kam qenë kundër. Në vitin 2003 ky Kuvend ka miratuar me konsensusin e të dyja partive: Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste, një ligj për kthimin dhe kompensimin e pronave, të asistuar nga OSBE-ja, pra nga teknika më e mirë legislative që i është ofruar Kuvendit të Shqipërisë në atë kohë.

Ndërkohë, ju merrni një iniciativë tjetër, duke u nisur nga një këndvështrim tjetër, për gjykimin tim, që nuk ka të bëjë me të drejtën, por ka të bëjë me mundësitë. Pra, nuk keni marrë si element bazë të drejtën, sa respektohet ajo, në gjykimin tim, sipas Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, por sa mundësi ka shteti shqiptar për ta realizuar këtë detyrim që ka karshi pronarëve. Standardet janë dyfishe, që duhet të jetë të paktën një preokupim për ju si Agjenci e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, sepse shteti tenton të legalizojë falas, për atë që është grabitur, ndërsa nga ana tjetër kërkon të kompensojë sipas mundësive pronarin, të cilit i është grabitur prona. Në gjykimin tim, ky është një standard krejt i papranueshëm dhe i palogjikshëm, për sa kohë ju jeni agjencia që mbron pikërisht respektimin e të drejtës së pronësisë, kthimin dhe kompensimin e saj.

Unë mendoj se kjo nuk është një çështje thjesht ekzekutive. pa dyshim që do të vijë në Kuvendin e Shqipërisë, por iniciativa të tilla, për sa i përket çështjes së pronës, përgjithësisht e kanë pasur burimin këtu, në Kuvendin e Shqipërisë. Ndryshimet dhe mendimet ligjore kanë pasur, për shkak të momenteve që kanë kaluar, edhe pranë ekzekutivit, por gjithmonë duke tentuar në përmirësimin. Në fakt ka një problem, që ka shumë ligje të cilat shpesh kanë krijuar edhe pamundësinë e një ligji integral dhe funksional, por ajo që unë shikoj me shqetësim – po e them sinqerisht – janë dy gjëra:

agjencia nuk po vepron në drejtimin e duhur për të bërë detyrën e saj ekzekutive, për të cilën është ngritur, që është kthimi dhe kompensimi i pronave, shqyrtimi dhe vendimin, përcaktimin e fondit të kompensimit fizik – sepse aty është elementi i parë nga i cili del fondi i kompensimit financiar. Për më keq, juve ju janë hequr rreth 18 mijë hektarë që keni pasur në dispozicion, me një vendim qeverie, që është kaluar pastaj për interesat e politikave zhvillimore. Është zëvendësuar përsëri? Në qoftë se është zëvendësuar, kanë qenë 18, duhej të ishin 36. Atëherë, 23 është aktualisht. Duhej të ishin 23 plus 18, apo është rikthyer 18?

Megjithatë, e kam fjalën se fatura e kompensimit financiar – që është preokupimi juaj dhe preokupimi i të gjithëve – është goxha e lartë dhe është një faturë që vjen për efekt se qeveria ose qeveritë përgjithësisht, nuk tentojnë të kthimi dhe kompensimi fizik, që është edhe atribut i agjencisë suaj. Prandaj, unë mendoj se ndoshta, të paktën këtë herë, në Kuvendin e Shqipërisë të mos shkojmë me një relacion tjetër, që ka të bëjë me historikun e zgjatjes së afateve të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, por me atë që ju paraqitet këtu. Që jeni në fazën e bërjes së një projektligji tjetër, dhe për sa kohë të bëhet ky projektligj, nuk mund të ketë veprime në kthimin dhe kompensimin e pronave. Kjo do të ishte shumë herë më relevante dhe shumë herë më transparente, qoftë me opinionin publik, qoftë me pronarët, por edhe me deputetët e Kuvendit të Shqipërisë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Diskutimet i mbyllem, sepse s’paska të tjera.

Kush është dakord në parim? Kundër? Një kundër.

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull.

(Diskutime pa mikrofon)

S’ka gjë. Ju lutem!

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, jo. të lutem!

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem! Ju lutem!

(Diskutime pa mikrofon)

Ja, t'jua them unë.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Mediu – Ky relacion, çfarë thotë?

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

(Diskutime pa mikrofon)

Votuam në parim dhe jemi vetëm një votë kundër, asnjë abstenim, dhjetë vota pro.

Neni 1.

Zoti Fino.

(Diskutime pa mikrofon)

Bashkim Fino – O Mediu, nuk e kam për të bërë shou. Ti vetë the se tërhiqesh.

Po u tërhoq Fatmiri, dakord jam unë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 1. Dakord!

Faleminderit!

Neni 2. Dakord!

Faleminderit!

Neni 3: “Hyrja në fuqi”. Dakord! Faleminderit!

Në tërësi, kush është dakord? Kundër? S’ka. Abstenime? S’ka.

Me 11 vota pro, miratohet edhe në tërësi.

Faleminderit! Punë të mbarë!

Pikat e tjera shtyhen, për shkak të kuorumit.

(Diskutime pa mikrofon)

Do t’ju njoftojmë. Faleminderit!

Nesër nuk ka mbledhje komisioni.

MBLEDHJA MBYLLET

